

VENDIM
Nr. 416, datë 21.6.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 313, DATË 15.5.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019,
MIRATUAR PËR KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PËR
ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E VETËQEVERISJES
VENDORE TË VITIT 2019”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 86, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 313, datë 15.5.2019, të Këshillit të Ministrave, shifra 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) ndryshon dhe bëhet 200 000 000 (dyqind milionë).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama